



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.5110/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.07.2022 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2021

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin financiar për periudhën Janar - Qershor 2022.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i financiar për periudhën Janar- Qershor 2022 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2022 është në shumë prej 2,759,758.00 €. Në kategorinë Paga dhe shtesa shpenzimi është në shumë prej 845,636.78€ ose 48.15%, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 97,003.58 € apo 25.13%, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 29,238.28 € apo 43.19%, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 28,532 € apo 35.67%, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 49,999.89 € apo 10.99% .Totali i shpenzimit për periudhën Janar - Qershor të vitit 2021 është në shumë prej 1,050,410.53 € apo 38.06 %. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 157,791.86 € të hyra vetanake për periudhën Janar- Qershor 2021 apo 41.3% e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2021 kemi një rënie prej 34,720.24 € apo për 18%, (duke pasur parasysh që planifikimi i të hyrave për vitin 2022 është në shumë prej 381,347 € ndërsa për vitin 2021 është 288,624 €).
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 28.07.2022

Anëtar i më i vjetër i Kuvendit në cilësinë e Kryesuesit

Zaim Bela





Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5505 /2022

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 11, 12, 40, Ligjit Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, neni 3, paragrafi 1.32, 1.43, neni 17 paragrafi 1, Ligjit Nr. 03L/-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30, paragrafi 1, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 28.07.2022 merr këtë:

VENDIM
PËR RIALOKIM TË MJETEVE NË KATEGORINË EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE
KAPITALE

1. Miratohet kërkesa me nr.04/5505 2022 e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për rialokim të mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale.
2. Rialokimi i mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale është në shumë prej 37,695.00 €, Pra, rialokimi i mjeteve në total për komunën e Hanit të Elezit është në shumë prej **37,695.00 €** nga fondi 21 sipas programeve/nën-programeve buxhetore.

Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, burimi i financimit (21).

Në kuadër të nën-programit Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620).

Rialokohen nga projektet:

7. "Ndërtimi i fushave sportive në fshatin Rezhancë, Lagija Meliq dhe Lagija e re", kodi (51723) në shumë prej 5,000.00€;
8. "Asfaltimi i rrugës Gorancë-Krivenik", kodi (47270) shuma prej 5,000.00 €;
9. "Ndërtimi i mureve mbrojtëse nëpër zonat rurale dhe urbane", kodi (50146) shuma prej 5,000.00 €,
10. "Vendosja e paisjeve digjitale E-Kioska në Han të Elezit", kodi (51721) shuma prej 10,000.00 €,
11. "Pyllëzimi i zonave të zhveshura në njësinë menaxhuese Uji i Bardhë", kodi (51600) shuma prej 3,000.00 €,
12. Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik", kodi (51576) shuma prej 9,695.00 €,

Rialokohen në projektet:

- "Ndërtimi i qendrës kulturore në Han të Elezit", kodi (48921) në shumë prej 5,000.00 €
- "Rregullimi i kanalizimeve në Han të Elezit në Rr.Isa Berisha dhe zonat rurale në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Krivenik, Dimçë", kodi (51581) në shumë prej 5,000.00 €;
- "Ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Dermjak, Paldenicë, Pustenik, Seçishtë", kodi (51720) në shumë prej 18,000.00 €;
- "Ndërtimi i qendrës kulturore në Han të Elezit", kodi (48921) në shumë prej 9,695.00 €.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë, pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive Komunale,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Data : 28.07.2022
Hani i Elezit

Anëtar i me Vjeër i Kuvendit në cilësinë e Kryesuesit





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5504/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 neni 11,12,40 , si dhe nenin 17 shkronja (f), neni 6 paragrafi 1 Ligjit nr.2003/11 për Rrugë i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.03/L-120 për Rrugë, Ligjit nr.06/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2003/11 për Rrugë i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.03/L-120 për Rrugë neni 3 paragrafi 5.2, neni 11 paragrafi 16.1, neni 12 paragrafi 18.1 të Ligjit nr.03/L-120 për Rrugë, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.03/L-120 për Rrugë, Ligjit nr.06/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2003/11 për Rrugë. Memorandumin e mirëkuptimit për financimin e projekteve infrastrukturore, ndërmjet MMPH-së dhe Infrastrukturës dhe Komunës së Hanit të Elezit, me numër 02/5096 e datës 08.07. 2022 si dhe Statutin e Komunës së Hanit të Elezit, neni 11, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.07.2022 merr:

VENDIM

**PËR MIRATIMIN DHE REALIZIMIN E PROJEKTIT TË RI KAPITAL “NDËRTIMI I RRUGËS
RAMUKË-KROI I FSHATIT PALDENICË”**

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për realizimin e projektit të ri kapital “Ndërtimi i rrugës Ramukë - Kroi i fshatit Paldenicë” në shumë prej 213,000 €.
2. Projekti në tërësi do të financohet nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit për Financimin e Projekteve Infrastrukturore të nënshkruar në mes të Ministrisë së lartpërmendur dhe Komunës së Hanit të Elezit me datë 08.07.2022.
3. Ky projekt infrastrukturor do të realizohet pjesërisht në vitin 2022 në shumë prej 50,000 € dhe vitin 2023 në shumë 163,000 €.Vlera totale e projektit është në shumë prej 213,000 €.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës

Hani i Elezit
Data: 28.07.2022

Anëtar i Kuvendit në cilësinë e Kryesuesit

